

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E HËNË 23 MAJ 2022

Zoti Balla,

Nuk mbulohet dielli me shoshë! Nuk e mbuloni dot korrupsionin galopant edhe këtë herë, duke përmendur emrin e një fondacioni amerikan! Në fakt, unë kisha shumë shpresë, sepse jam e sigurt që një pjesë e deputetëve tuaj, në heshtje, nën zë, nuk e duan këtë që po ndodh me Butrintin, siç nuk kanë dashur as atë që keni bërë me Teatrin Kombëtar. Ndaj, me keqardhje them se ju do të mbaheni mend si deputetët që keni kryer krime historike, kulturore, arkeologjike të trashëgimisë kulturore! Nuk do të jeni në Wall of Fame, por do të jeni në Wall of Shame!

Qeveria propozon sot miratimin e një forme të re të menaxhimit të Parkut Arkeologjik të Butrintit. Kjo marrëveshje ka një kosto të tmerrshme dhe themelin e ka te babëzia për të zhvatur çdo pasuri të këtij vendi. Qeveria para se të arrinte marrëveshjen që na propozohet sot për miratim, kishte arritur një marrëveshje të fshehtë me oligarkët e saj për t'i hequr Parkut Arkeologjik të Butrintit dhe Trashëgimisë Kulturore Botërore 830 hektarë tokë për ta betonizuar atë. Pra, në thelb është njësoj si ligji i posaçëm "Rama-Fusha", e mbani mend, ku do të ngriheshin ato 6 kullat e larta për fitime personale të Edi Ramës. Në vend të pasurisë kombëtare, qeveria e Edi Ramës zgjodhi pasurimin, edhe një herë, e një grushti njerëzish për të ndërtuar një resort turistik me 630 vila në zonën e shkëputur nga Butrinti.

Praktikisht, sot në diskutim duhet të merremi me formën e menaxhimit, por më e rëndësishmja është ajo që po ndodh me këto 830 hektarë, që po i hiqni nga zona e mbrojtur për të ndërtuar 630 vila të oligarkëve të Edi Ramës. Qeveria na përmend këtu modelin italian, pra na sjell Fondacionin Amerikan dhe na thotë: "Heshtni, se kemi një fondacion amerikan!". Është e vërtetë që në Itali në vitin 2014 u propozua reforma për muzetë dhe parqet arkeologjike, por nuk kishte të bënte vetëm me një zonë të caktuar. Reformës italiane iu nënshtruan plot 30 muze dhe parqe arkeologjike publike dhe, në asnjë rast reforma nuk u përdor për t'u dhënë klientëve të kryeministrit italian pasuritë kulturore të trashëgimisë botërore.

Koloseu dhe Forumi Romak kanë një menaxhim të ri, por kryeministri italian nuk është angazhuar për të ngritur resorte brenda tyre. Kush thotë se nuk do të ketë asnjë veprimtari tregtare brenda parkut, po bën sikur nuk kupton për të mashtruar njerëzit. Në kufijtë e pakësuar të Parkut të Butrintit, siç është

tani, ne e dimë që nuk do të ndërtohet, por plani për vjedhje nga qeveria, në bashkëpunim me oligarkët e saj, është verifikuar. Parkut të Butrintit Edi Rama i ka hequr 800 hektarë, për të ndërtuar resorte në këtë zonë, që deri para pak kohë më parë i përkisnin Trashëgimisë Kulturore Botërore. Do të ndërtohen deri tani jo 1, por 2 resorte.

Ky vendim i Edi Ramës për t'i hequr parkut të Butrintit 830 hektarë tokë është një krim tjetër i paralajmëruar! Nuk ka asnjë ndryshim me shkatërrimin që i bë Teatrit Kombëtar në mes të pandemisë, në mes të natës, me mijëra policë, me qëllim për të ndërtuar kulla të tjera në zemër të Tiranës. Teatrit, si Butrintit, iu hoq mbrojtja si monument kulture, pastaj u shemb nga i njëjti person, Kryeministri i vendit, që sot ka hequr nga mbrojtja e trashëgimisë kulturore të Butrintit 800 hektarë për t'i betonizuar. Kjo është një histori e pastër korrupsioni. Media ka sjellë fakte se Komiteti i Investimeve Strategjike e rrëzoi projektin e vilave në dhjetor të 2021-it, por e miratoi atë pas 2 muajsh. Çfarë ndodhi? Pse ndryshoi mendim Edi Rama nga dhjetori në shkurt?

Edi Rama duhet të japë llogari, sepse është i përfshirë direkt në këtë aferë kriminale, që ka pasoja ta pakthyeshme për pasurinë kombëtare dhe trashëgiminë kulturore. Ajo që dimë me siguri është se nga dhjetori në shkurt nuk ndryshoi mendimi kundër ndërtimit të resortit i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Në të dyja rastet Agjencia vuri në dukje se një ndërtim i tillë propozohet të kryhet brenda zonës së mbrojtur nga ligji kombëtar dhe konventat ndërkombëtare të UNESCO-s. Edi Rama nuk mund të fshihet dot pas gjoja marrëveshjes për menaxhimin e ri të Butrintit. Si kryetar i Komitetit për Investimet Strategjike, në vendimin e dhjetorit kundër resortit, Edi Rama pranoi se sipërfaqja ku propozohet të shtrihet projekti është brenda zonës së Parkut Kombëtar të Butrintit.

Kjo është e shkruar e zeza mbi të bardhë, sepse zona është shpallur zonë e mbrojtur sipas Konventës Ndërkombëtare të Ramsarit dhe bën pjesë në trashëgiminë kulturore të UNESCO-s. Megjithatë, Edi Rama nuk hoqi dorë, por u kërkoi institucioneve ta zgjidhnin konfliktin në favor të ndërtimit të resortit. Edhe kjo është e shkruar e zeza mbi të bardhë. Një hetim serioz dhe i pavarur nga Prokuroria e Posaçme minimalisht do të gjente shpërdorim të pastër të detyrës nga Kryeministri i vendit. Në rastin e Parkut të Butrintit, ai ka mbrojtur vetëm interesat private kundër interesit publik për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Sigurisht edhe këtë herë u bë ashtu siç donte Edi Rama, pavarësisht kundërshtimit të të gjithë profesionistëve të fushës, pavarësisht kundërshtimit të dytë nga Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura, 830 hektarë të parkut të Butrintit u hoqën nga kufiri i zonës së mbrojtur dhe, në shkurt, Komiteti për Investimet Strategjike, i drejtuar nga Kryeministri, i hapi rrugë ndërtimit të resortit privat në pronën publike.

Ironia më e madhe e kësaj historie korruptive kriminale është se Edi Rama ka injoruar Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe i ka lënë investitorit të resortit të realizojë vlerësimin për trashëgiminë kulturore të zonës ku do të ndërtojë. Pra, Edi Ramës i ka thënë ndërtuesit të 630 vilave të bëjë vlerësimin arkeologjik mjedisor dhe ai t'u thotë shqiptarëve çfarë impakti do të ketë resorti i tij në ekonominë shqiptare.

Të nderuar qytetarë!

Sa herë të shihni e të dëgjoni Edi Ramën, që bën si i dashuruar (apasionuar) pas reformave, duhet ta dini se mbrapa tyre qëndron një histori korrupsioni dhe zhvatje, si kjo e parkut të Butrintit. Që nga dita e parë ligji "Rama" për Investimet Strategjike nuk ka pasur qëllim të thithë investime të huaja të rëndësishme. Ky ligj po përdoret prej 5 vjetësh për të grabitur pronat publike dhe private, veçanërisht në bregdet, në favor të një grushti oligarkësh pranë Kryeministrit. "Në emër të këtij ligji, që korrupton logjikën e investimit", siç shprehet Departamenti i Shtetit, Edi Rama i ka dhënë leje për resort edhe ish-ministres së tij të Mbrojtjes. Është koha që Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion të veprojë pa pritur se kush do ta ketë radhën në grabitjen e mëtejshme të pasurive kombëtare për llogari të një grushti njerëzish me pushtet.

Si fillim, hetimi do të zbulonte para kriminale, klientelizëm dhe kapje të shtetit nga oligarkët. Edi Rama e ka shtyrë 2 herë afatin për ligjin korruptiv për investimet Strategjike. Tani e dimë pse ligji që duhet të kishte pushuar së ekzistuari në dhjetor 2021, u shty për herë të dytë, edhe 2 vjet të tjera. Në dhjetor afera korruptive e Butrintit nuk ishte mbyllur akoma. Si kjo do të ketë dhe shumë të tjera, nëse drejtësia nuk vepron.

Për ta mbyllur, përgëzoj dhe mbështes çdo nismë qytetare në mbrojtje të Parkut Kombëtar të Butrintit! Vlerësoj jashtëzakonisht shumë krijimin e Aleancës për Mbrojtjen e Butrintit, si një akt qytetarie dhe kuraje e njerëzve, që nuk blejnë dhe as shesin interesin publik! Faleminderit!